

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Konventa e Këshillit të Evropës për Akses në Dokumentet Zyrtare

Konventa e Këshillit të Evropës për Akses në Dokumentet Zyrtare (CETS Nr. 205), e njohur gjithashtu si Konventa Tromsø është instrumenti i parë ligjor ndërkombëtar detyrues që njeh të drejtën e përgjithshme të aksesit në dokumentet zyrtare të zotëruara nga autoritetet publike.

Së fundmi Shqipëria ka ratifikuar Konventën 205 (miratuar me ligjin nr. 45/2022 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për aksesin në dokumente zyrtare" e cila hyri në fuqi më 1 nëntor 2022.

Konventa Tromsø përbën një moment historik në promovimin e qeverisjes demokratike, hapjes, demokracisë pjesëmarrëse dhe në ushtrimin e të drejtave të tjera të njeriut dhe lirive themelore.

Konventa Tromsø bazohet në tre parime kryesore:

- Transparenca e autoriteteve publike;
- Vetëzhvillimi i qytetarëve dhe ushtrimi i të drejtave të tyre themelore të njeriut;
- Besimi i publikut tek autoritetet publike.

Konventa përcakton një sërë standartesh minimale për përpunimin e shpejtë dhe të drejtë të kërkesave për akses në dokumentet zyrtare që Palët në Konventën e Tromsø marrin përsipër të zbatojnë. Fryma e saj është inkurajimi i Palëve që të forcojnë dispozitat e brendshme që lejojnë një të drejtë më të gjerë aksesit në dokumentet zyrtare.

Konventa përfshin gjithashtu procedurat e rishikimit për kërkesat e informacionit kur u mohohet aksesit.

Edhe pse Konventa Tromsø parashikon një të drejtë të përgjithshme për akses në dokumentet zyrtare, kufizimet e kësaj të drejte mund të justifikohen vetëm në rastet e parashikuara në Konventë.

Përmbledhje mujore e vendimeve

VENDIM NR. 42 - AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

VENDIM NR. 43 - MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

VENDIM NR. 47 - UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU

VENDIM NR. 53 - INSPEKTORIATI I MBROJTJES SË TERRITORIT PRANË BASHKISË TIRANË

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË NJË nga SHTYLLAT
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit nëntor 2022, ka dhënë 4 vendime urdhërimi për vënien në dispozicion të informacionit në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI).

Me anë të vendimit nr. 42 datë 02.11.2022, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Kërkuesi ka kërkuar informacion që lidhet me situatën e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 2.10.2019 "Për sigurimin e ndërtimeve", në të cilën Autoriteti Publik ka deklaruar se: "...në vazhdim, ka monitoruar ofrimin e këtij produkti të detyrueshëm, nëpërmjet raportimeve të bëra nga shoqëritë e sigurimit",

Kërkuesi ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion informacioni në lidhje me:

1. Bazuar në këto kontrolle a ka konstatuar Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare një situatë të shpërpjestuar sa i përket raporteve mes kompanive të sigurimit?
2. Nga kontrollet që keni ushtruar a keni konstatuar praktikën që Kompanitë e Sigurimit bëjnë oferta për sigurimin e godinave deri në 50 përqind më të ulëta se sa limiti fundor i përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 2.10.2019 "Për sigurimin e ndërtimeve"?
3. A është risiguruar nga kompanitë e sigurimit ky portofol që konsiderohet me rrisht të lartë, për të garantuar sigurinë e klientëve?

Autoriteti Publik në përgjigjen e tij ka refuzuar dhënien e informacionit me argumentin se "Informacioni dhe çdo e dhënë që AMF disponon ose merr në funksion të ushtrimit të detyrave mbikëqyrëse dhe rregullative trajtohet si informacion konfidencial".

Pas përgjigjes së Autoritetit Publik, kërkuesi me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur", Zyra e Komisionerit ka kërkuar qëndrimin e Autoritetit Publik, në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik ka rikonfirmuar qëndrimin e reflektuar në përgjigje të kërkesës, si dhe duke sqaruar se: "Të dhënat, që i vihen në dispozicion Autoritetit për veprimtarinë e subjektit të mbikëqyrur, klasifikohen "Informacion konfidencial" nëse përhapja e tyre çënon interesat tregtarë ose emrin e mirë të subjektit...Klasifikimi i informacionit bëhet me rregullore të brendshme, të miratuar nga Bordi. ...Anëtarët e Bordit, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit janë të detyruar t'i ruajnë dhe të mos i shpërndajnë informacionet konfidenciale". Ruajtja e konfidencialitetit është detyrim bazuar dhe në ligjin nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", neni 72, pika 2 dhe 5, ku parashikohet se "...shoqëria e sigurimit jep informacion kur ...informacioni kërkohej nga Autoriteti ose nga autoritetet e tjera mbikëqyrëse, me qëllim ushtrimin e mbikëqyrjes brenda kompetencave të tyre". "Autoriteti, autoritetet e tjera mbikëqyrëse, organet hetimore dhe gjyqësore e përdorin informacionin e parashikuar në pikën 2, të këtij neni, vetëm për qëllimet për të cilat është dhënë informacioni".

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga Autoriteti Publik se, informacioni i kërkuar, konkretisht për pikën 5 të kërkesës për informacion, kopje e procedurave të tenderit/tenderave për shpalljen fitues të shoqërive/kompanive për ndërtimin e pallateve, është i disponueshëm në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron.

Nëse do të analizonim dispozitat e sipërcituara në raport me kërkesën për informacion, del qartë se Autoriteti Publik ka bërë një interpretim të gabuar të tyre. Objekti i kërkesës për informacion nuk konsiston në emra konkretë të subjekteve të mbikëqyrur të cilëve nga përhapja e informacionit mund t'ju cënohet interesi tregëtar apo emri i mirë i tij, por në të dhëna të përgjithshme të cilat kanë dalë nga mbikëqyrja e realizuar nga ky Autoritet Publik. Të dhëna këto, të cilat mund të bëhen pjesë e raporteve të cilat publikohen nga ky Autoritet Publik në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së tij.

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se, parashikimet e dispozitave të sipërcituara janë të zbatueshme për ato raste kur informacioni nuk përbën informacion publik në kuptim të LDI dhe dhënia e tij kryhet në një kontekst të caktuar.

Në përfundim Zyra e Komisionerit vendosi, urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion. Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuesit çdo informacion/dokument, i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, duke mbajtur në konsideratë parashikimin në nenin 17, të ligjit të sipërcituar. Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMPDP www.idp.al.

“Ditët e Transparencës” me Autoritetet Publike të Qarkut Dibër

Transparenca është faktor në përmirësimin e qeverisjes dhe forcon besimin e qytetarëve te institucionet publike. Në kuadër të nismës “Ditët e Transparencës”, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me ambasadën e Britanisë së Madhe në Shqipëri, zhvilluan takimin e 6-të në qytetin e Peshkopisë me autoritete publike të qarkut të Dibrës.



Në aktivitet morën pjesë Komisioneri, z. Besnik Dervishi, SH.T.Z. Alastair King-Smith, Ambasador i Britanisë së Madhe, z. Nexhbedin Shehu, Prefekt i Qarkut, z. Rahim Spahiu, Kryetar i Bashkisë Dibrë, deputetë, drejtues/përfaqësues të njësive të tjera të vetëqeverisjes vendore të qarkut, të institucioneve të sistemit të drejtësisë, prokurorisë, policisë së shtetit, strukturave rajonale të institucioneve qendrore dhe koordinatorët e tyre për të drejtën e informimit.



Në këtë aktivitet u vlerësua dhe u diskutua për ecurinë e përmbushjes së detyrimeve të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, për garantimin e ushtrimit të kësaj të drejte dhe nxitjen e transparencës proaktive e llogaridhënies së institucioneve publike. Zbatimi i kuadrit rregullator të fushës ndikon, njëkohësisht, edhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve që ofrohen për qytetarët. Nga monitorimi në vijimësi dhe analizimi i situatës, Zyra e Komisionerit konstaton domosdoshmërinë për efektivitet më të madh në përditësimin e të gjithë elementeve përbërëse të Programit të Transparencës dhe Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve. Nga ana tjetër, u kërkuar angazhim maksimal për rritjen e cilësisë së procesit të trajtimit të kërkesave për informacion nga qytetarët apo grupet e interesit, si dhe të forcohet bashkëpunimi me ta për kultivimin e kulturës së transparencës.

Zbatimi i të drejtave të qytetarëve në veprimtarinë e administratës tatimore dhe asaj doganore

Përmbushja e detyrimeve rregullatore në fushën e të drejtës për informim dhe atyre për mbrojtjen e të dhënave personale forcon kulturën e integritetit dhe llogaridhënies në ushtrimin e funksioneve nga administrata tatimore dhe ajo doganore.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për 4 ditë me rradhë, zhvilluan trajnime me pjesëmarrjen e më shumë se 60 nëpunësve të niveleve dhe strukturave të ndryshme qendrore dhe vendore, të këtyre institucioneve.

Në fokus të aktivitetit ishte njohja e zgjeruar e legjislacionit në fuqi për të dy fushat e përgjegjësisë të Zyrës së Komisionerit, roli e funksionet e saj, si dhe zbatimi i këtij kuadri rregullator në raport me veprimtarinë e administratës tatimore dhe asaj doganore. Vëmendje iu kushtua, nëpërmjet shqyrtimit të rasteve specifike të shqyrtuara nga autoriteti ndër vite, forcimit të transparencës proaktive të këtyre institucioneve, trajtimit të dy të drejtave në balancë me njëra-tjetrën, si dhe masave tekniko-organizative për nivel të lartë sigurie në përpunimin e të dhënave personale. Në optikën e zhvillimit teknologjik dhe digjitalizimit të shërbimeve kërkohet ndërveprim me përgjegjshmëri e transparencë me qytetarët apo grupet e interesit, për krijimin e kushteve optimale të ushtrimit në praktikë të të drejtave të tyre.




Trajnimi u zhvillua në mjediset e Zyrës së Komisionerit nga znj. Besa Velaj Drejtor i Kabinetit, znj. Elona Hoxhaj, Drejtor i Përgjithshëm për të Drejtën e Informimit dhe znj. Pjerina Gaxha, Drejtor i Përgjithshëm për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Autoriteti është i gatshëm për të zhvilluar trajnime të kësaj natyre edhe me institucione të tjera të rëndësishme të administratës shtetërore/publike, për njohjen me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut në funksion të përmirësimit të veprimtarisë së tyre.

Bashkëpunimi me Universitetin Mesdhetar, forcim i kulturës së ushtrimit të të drejtave të qytetarëve

Njohja e të drejtave dhe lirive themelore nga brezi i ri është një nga rrugët më efikase për kultivimin dhe zgjerimin e kulturës së ushtrimit të tyre në praktikë.

Njohja e të drejtave dhe lirive themelore nga brezi i ri është një nga rrugët më efikase për kultivimin dhe zgjerimin e kulturës së ushtrimit të tyre në praktikë.



Me ftesë të Univerisitetit Mesdhetar të Shqipërisë, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, mbajti një leksion të hapur për studentë dhe stafin akademik të Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Në këtë aktivitet u paraqit një historik i evoluimit të legjislacionit për të dy fushat e përgjegjësisë së institucionit, e ku të pranishmit u njohën me rolin, funksionet dhe veprimtarinë e tij në kuadër të monitorimit dhe mbikëqyrjes së kuadrit rregullator.

Me interes për studentët ishte trajtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale në epokën digjitale, ku i rëndësishëm është informimi i qytetarëve nga kontrolluesit/përpunuesit për të drejtat e tyre. Nga ana tjetër, nëpërmjet shembujve nga praktika, u ofruan këshilla konkrete për sjelljen e tyre në funksion të mbrojtjes së privatisë. Në këtë leksion të hapur, Komisioneri foli edhe për fushën e të drejtës për informim, për forcimin e transparencës proaktive të autoriteteve publike, për përgjegjshmërinë dhe integritetin e tyre në funksion të pjesëmarrjes sa më të madhe të qytetarëve në mirëqeverisje.

Bashkëpunimi i konsoliduar me institucionet e arsimit të lartë (IAL), publike e private, është një nga drejtimet kryesore të nismave ndërgjegjëse të Zyrës së Komisionerit, të cilat zhvillohen në mënyrë periodike.